REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr. 319 Prot

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Maliq, më 17.01.2025

Projekt-Vendim – Nr. 15

Mbi përdorimin e fondit për projektin ***"Shërbime mbështëtëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar"*** me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq, viti i tretë.

Në mbështetje të ligjit nr . 139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqiperisë", dhe ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar", si dhe shkresës nr. 5245/53 prot, datë 30.12.2024 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për celjen e fondit prej lekë për vitin 2025.

Kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Maliq:

1. Të miratojë përdorimin e fondit të deleguar nga Fondi Social i MSHMS me vlerë totale lekë (për vitin 2025) për zbatimin e projektit ***"Shërbime mbështëtëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar"***, të detajuar si më poshtë ;
   1.1 Miratim fondi me vlerë 1152232 lekë për paga dhe sigurime të punonjësve si dhe shpenzimet operative që do të ofrojnë këtë shërbim sipas buxhetit të projektit;

Nr	Aktiviteti	Emertimi pozicionit	Llogaria 600	Llogaria 601	Llogaria 602	Shuma
1	1 punonjes	Koordinator shërbimi(paga 58000 leke /muaj)	696000	116232		812232
2	Shpenzime operative /	Banke ushqimore			220000	220000
		Kosto administrative (karburant Gaz oil)			70000	70000
3	Mbeshtetje direkete ne familje	Ndihme financiare per shpenzime mjekesore			50000	50000
Totali			696000	116232	340000	1152232

2. Ngarkohet Sektori i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi mbas miratimit nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut Korçë .

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi : Dr. Drejtoria E Shërbimit Social Arsimit Dhe Shëndetësisë	E.Petriti		Dt 17.01.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË

Nr. 319 Prot.

Maliq, më 17.01.2025

Relacion

Mbi projektin ***"Shërbime mbështëtëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar"*** me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq

Në mbështetje të ligjit nr . 139 /2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqiperisë", dhe ligjit nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në republikën e shqipërisë", dhe vkm-së nr. 518, datë 04.09.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar", Bashkia Maliq në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Vazhdon shërbimin në familje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuar .

Ky shërbim ka si qëllim kryesor ngritjen e nje shërbimi për te moshuarit dhe familjeve në nevojë ku prinderit jane me AK , me qellim zgjerimin e hartës së shërbimeve, në njesite të cilat nuk kane sherbime ne zone dhe kane nje distance te larget nga ofruesit e sherbimeve ne qender dhe eshte i lidhur me permbushjen e Prioritetit strategjik 1dhe 4 si dhe Objektivit specific 1 dhe 2 te Planit Social të bashkisë Maliq.

Përfitues të këtij shërbimi janë banorë të moshuar të vetmuar në Bashkinë Maliq; familjet e personave me afteëi të kufizuar , persona me aftësi të kufizuar ; familjet dhe qytetarët në nevojë. punonjësve sociale. rrethi i gjerë familjar i familjeve target; punonjës të strukturave të posaçmetë shërbimeve sociale pranë bashkisë; punonjësit e shërbimit social shtëtëror; punonjësit e njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit në çdo njësi administrative; profesionistë të tjerë të shërbimeve psikosociale të sitemit shëndetësor dhe arsimor në nivel vendor.

Aktivitetet kryesore të këtij shërbimi do të jenë

1. *Mbështetje psiko sociale përmes ofrimit të informacionit, këshillimit dhe advokimit.*
2. *Mbeshtetje higjeno-sanitare ne familje*
3. *Sigurimi i aksesit në rrjetet e shërbimeve në komunitet*
4. *Mbështje për aftësim profesional, punësim per familjet me persona me AK*
5. *Ofrimi i kujdesit afatshkurtër në shtëpi.*
6. *Identifikim dhe referim për mbështetje, i ndihmesit personal te personave ne nevoje*
7. *Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese për gjithperfshirjen e personave me AK dhe per moshen e trete*
8. *Trajnime të stafit mbi shërbimin në familje*

Shuma e deleguar nga Fondi Social për vitin 2025 është 1152232 lekë
Ky shërbim do të përfshijë kryesisht të moshuar të vetmuar në nevojë për mbrojtje duke ju ofruar atyre kujdes higjenosanitar ne banesë , kujdes afatshkurter për nevoja të ndryshme si mediikamente , mbështetje në natyrë me paketa veshje dhe eleltro shtëpiake sipas rastit dhe problematikave të tij, infromim dhe orientim drejt shërbimeve të tjera të ofruara nga aktorë të ndryshëm lokalë , aktivitete të ndryshme etj.
Gjithashtu një vëmendje do ti jepet edhe familjeve që kanë prindër me aftësi të kufizuar në ndihma higjenosanitare dhe ushqimore, asistencë në menaxhimin e të ardhurave të familjes dhe orientim dhe këshillim mbi arsimin e fëmijëve apo bashkepunimeve me zyrën e punës për punësimin e personave me AK.

Ky shërbim do të jetë një pikë kthese në ofrimin e shërbimeve duke i orientuar ato në ambientin familjar duke parandaluar edhe institucionalizimin e përfituesëve të këtij program.

	(Emër Mbiemër)	Nënshkrimi	Data
Konceptoi : Dr. Drejtoria E Shërbimit Social Arsimit Dhe Shëndetësisë	E.Petriti		Dt 17.01.2025

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ